

# Central-Praxis prezantohet

E dashur paciente, i dashur pacient,  
klinika jonë është e specializuar për sëmundjet e stomakut  
dhe zorrës së trashë dhe ofron të gjithë spektrin e gastroen-  
terologjisë. Fokusi ynë kryesor është endoskopia diagnos-  
tike dhe terapeutike (endoskopia e stomakut dhe zorrës).  
Për këtë, ne përdorim brezin më të fundit të teknologjisë së  
endoskopisë.

Në këtë broshurë, kemi përmbledhur për ju informacionet më të rëndësishme  
për koloskopinë e planifikuar. Në faqet vijuese gjeni një udhëzues për  
përgatitje dhe të dhëna të dobishme në lidhje me ecurinë e ekzaminimit.

Informacione të mëtejshme i gjeni edhe nën: [www.central-praxis.ch](http://www.central-praxis.ch)

## Përgatitja për koloskopi



Përgatitja optimale fillon katër ditë para ekzaminimit. Është e rëndësishme që zorra juaj të jetë plotësisht e pastruar, sepse vetëm atëherë mund të garantohet një diagnozë precize. Në rast se ka ndotje nga mbetjet, mund të ndodhë që të mos vihen re, p.sh. polipe dhe tumore. Përveç kësaj, farat, bërthamat apo ushqimet fibroze bllokojnë aparatit e ekzaminimit.

### Të ushqyerit e duhur gjatë përgatitjes

Katër ditë para ekzaminimit:

E duhur:

- Ushqim me përmbajtje të ulët fibrash (p.sh. bukë e bardhë)
- Çaj, lëngje (pa pulpën e frutit)
- Mish pule, mish viçi, peshk, produkte qumështi, vezë, patate të shtypura, oriz

E gabuar:

- Fruta dhe perime që përmbajnë bërthamë (p.sh. rrush, luleshtrydhe, kivi, domate, fiq, etj.)
- Ushqime me përmbajtje të madhe fibrash (p.sh. shpargull, fruta dhe perime të pagatuara, sallatë, drithëra, produkte me miell të pasitur, fara liri, arra, etj.)

Një ditë para ekzaminimit:

Vakti i fundit i përcaktuar:

- Dreka deri në orën 13:00 (p.sh. patate, brumëra, oriz, bukë e bardhë, djathë, vezë, çaj). Pas kësaj, nuk mund të merret vakt i përcaktuar!


Gjatë gjithë ditës lejohen:

- lëngjepa ngjyrë (pa gaz!), lëng mishi i holluar, glukozë, bonbone.

## Defekim me Moviprep® dhe X-Prep®

- Çfarë është Moviprep®? Ai është një pluhur për prodhimin e një tretësire për pastrimin e zorrëve. Pasi tretet në ujë dhe pasi të pihet, ai pastron zorrët tuaja.
- Çfarë është X-Prep®? Ai është një shurup ekstrakti nga frutat e kasies, i cili përdoret për defekim i kombinuar me Moviprep®.

### Përgatitja e një porcioni Moviprep®



- 1 Një paketë Moviprep® përmban dy bustina A dhe B (për dy porcione).
- 2 Për një porcion, përmbajtjen nga bustina A dhe B e derdhim në një enë. Shtojmë një litër ujë.
- 3 E përziejmë derisa lëngu të jetë pothuajse i kthjellët (mund të zgjasë disa minuta).  
**Sugjerim:** Ju sugjerojmë ta pini Moviprep® të ftohë ose me kallam.

### Pas glënjës së parë Moviprep®

Që nga ky moment deri në ekzaminim mos hani asnjë ushqim. Gjatë këtij intervali, do t'ju luteshim të pini të paktën edhe një litër tjetër lëng të kthjellët.

Kohët individuale për marrjen e medikamentit i gjeni në faqen 6.

## Marrja e Moviprep® dhe X-Prep®

1/2 e shishes



Kohët individuale për marrjen e medikamentit:

Sasia e parë

një ditë para

ditës së ekzaminimit

ora

1/2 e shishes



Sasia e dytë

në ditën e ekzaminimit

ora

Koloskopi deri në orën 13:00 Marrja e 1 litër 1 Moviprep®, çdo 1/2 shishe X-Prep® dhe çdo 1/2 litër lëng të kthjellët që ju zgjidhni një ditë përpara dhe në ditën e ekzaminimit (dy porcione gjithsej).

Koloskopi nga ora 13:00 Marrja e 2 x 1 litër Moviprep®, 2x1 1/2 shishe X-Prep® dhe 2 x 1/2 litër lëng të kthjellët që ju zgjidhni në ditën e ekzaminimit (dy porcione gjithsej).

- Pini një gjysmë shishe X-Prep® (afërsisht 37,5 ml) direkt para marrjes së Moviprep®.
- Pini një litër Moviprep® brenda 1 – 2 orësh.
- Përpquni të pini një gotë çdo 10 deri në 15 minuta.
- Ju rekomandojmë me patjetër që të merrni edhe të paktën një litër tjetër lëng të kthjellët që zgjidhni vetë.
- Pasi të keni marrë litrin e dytë të Moviprep® deri në fillim të ekzaminimit duhet të kalojë të paktën një orë për të arritur një pastrim të plotë të zorrës.
- Gjatë marrjes, qëndroni afër një tualeti.



# Koloskopia



Koloskopia shfaqet, ndër të tjera, nëpërmjet shqetësimesh barku të paqarta, gjak në fekale, nëpërmjet rënies në peshë në mënyrë të pashpjegueshme, si dhe nëpërmjet anemisë dhe mungesës së hekurit. Një shpjegim rekomandohet edhe në rastin e ndryshimeve në zakonet e fekaleve, si dhe në rastin e anamnezës familjare të trashëguar (kancer). Si rregull, duke filluar nga mosha 50 vjeç është me vend të bëhet një ekzaminim parandalues dhe mbulohet nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm.

## Përgatitja

Për të arritur një rezultat të duhur dhe të saktë të ekzaminimit është e domosdoshme që zorra të zbrazet plotësisht më parë. Ilaçet që merren shkaktojnë diarre, prandaj do të ishte me vend që përgatitja të kryhej në shtëpi në mjedisin tuaj të zakonshëm. Respektoni udhëzimin tonë dhe, në rast pyetjesh ose paqartësish, do t'u luteshim të na kontaktonit. Është absolutisht normale që zorra të përmbajë ende lëng edhe pas zbrazjes. Prandaj mos u irritoni nga kjo. Falë pajisjeve tona, këtë lëng mund ta largojmë pa problem.

Detajet për një përgatitje sipas takimit i merrni në „Përgatitja për koloskopi“ në faqen 4.

## Ecuria e koloskopisë

Në ditën e ekzaminimit ju presim në klinikën tonë në takimin e lënë. Oraret tona i planifikojmë në mënyrë të tillë që, brenda mundësive, të mos ketë kohë të gjata pritjeje. Gjatë bisedës paraprake, mjeku shpjegon plotësisht së bashku me ju gjendjen e shqetësimeve dhe u përgjigjet pyetjeve të mundshme ose pasiguritë nga ana juaj. Për ta ndërtuar ekzaminimin në mënyrën më komode të mundshme, ju jepet një medikament qetësues (hap gjumi), i

cili garanton heqjen e dhimbjeve dhe një ecuri pa probleme. Vetë ekzaminimi zgjat rreth 30 minuta. Në fund të tij bëhet sërish një bisedë me mjekun, i cili ju sqaron rezultatet dhe ju përgjigjet pyetjeve tuaja.

## Ekzaminimi

Falë marrjes së një medikamenti qetësues, ekzaminimi është pa dhimbje, gjë që garanton një ecuri pa probleme të ekzaminimit. Gjatë ekzaminimit, ne mbikëqyrim frymëmarrjen dhe qarkullimin e gjakut.

Gjatë ekzaminimit vëzhgohen të gjitha seksionet e zorrës së trashë dhe një pjesë e zorrës së hollë nëpërmjet një instrumenti optik dhe fleksibël (koloskop). Ekziston mundësia që të merren pa dhimbje kampionë të indeve. Gjatë ekzaminimit largohen gjithashtu pa dhimbje edhe polipe, shumëzime të mëdha indesh pak a shumë beninje. Në fund, kampionët dërgohen për t'u vlerësuar në një laborator të posaçëm. Në të shumtën e rasteve, polipet janë shumëzime beninje (adenoma). Megjithatë, ato mund të rriten dhe, me kalimin e viteve, mund të zhvillojnë kancer të zorrës së trashë. Rezultatet e kampionëve do t'i diskutojmë me ju dhe, në çdo rast, do të caktojmë një takim për një kolposkopi.

## Pas ekzaminimit

Do t'ju luteshim që të mos vini me makinë në këtë takim. Medikamentet që ju kemi rekomanduar dëmtojnë aftësinë për të drejtuar makinën. Përdorni mjetet e transportit publik ose lejoni t'ju shoqërojë një person tjetër. Menjëherë pas ekzaminimit ju mund të hani dhe të pini sërish si zakonisht, nëse mjeku nuk ju përshkruan diçka tjetër.


Rezultatet e ekzaminimit ju bëhen të ditura menjëherë pas përfundimit të tij. Vlerësimi i kampionëve të marra të indeve zgjat dy deri në tri ditë.

Nëse do të shfaqeshin anomali, do të informoheni. Në çdo rast, mjekut të familjes i dërgohet një raport.

## Polipet

Polipet janë shumëzime të mëdha indesh pak a shumë beninje. Por, megjë ato mund të zhvillohen edhe në malinje, ato hiqen në mënyrë rutinë.

### Marrja e indeve dhe heqja e polipeve të vogla dhe të mëdha



1 Heqja me pinca

2 – 5 Heqja me teleskop elektrik

### Rreziqe të mundshme të koloskopisë

Si ekzaminimi, ashtu dhe marrja e kampionëve të indeve dhe heqja e polipeve janë me rrezik të ulët. Pavarësisht kujdesit maksimal, në raste të veçanta mund të ketë hemorragji (0,5 deri në 3 përqind), të cilat mund të shfaqen direkt pas heqjes së polipeve ose edhe më vonë. Shumë rrallë (0,3 deri 0,5 përqind) mund të shfaqet shpim (perforim) i murit të zorrës, ku është i domosdoshëm të bëhet një operacion. Pas dhënies së medikamenteve qetësuese, në raste të rralla, mund të shfaqen vështirësi në funksionin e frymëmarrjes dhe zemrës, prandaj, gjatë ekzaminimit bëhet mbikëqyrja përkatëse.

## Fakte për identifikimin e hershëm të kancerit të zorrës së trashë

Që nga 1 korriku 2013, masat për didentifikimin e hershëm të kancerit të zorrës së trashë (colon carcinoma) paguhen nga sigurimi shëndetësor i detyruar (OKP) për të gjithë femrat dhe meshkujt nga moshë 50 deri në 69 vjeç. Prandaj, shumica e shoqatave profesionale mjekësore si dhe liga e luftës kundër kancerit ju rekomandojnë kryerjen e një ekzaminimi parandalues për parandalim të hershëm edhe personave që nuk kanë shqetësime. Metoda e besueshme është koloskopia.

### Kanceri i zorrës në Zvicër – Numra dhe fakte

Kanceri i zorrës bën pjesë të sëmundjet malinje më të shpeshta në Zvicër. Çdo vit, rreth 4100 veta preken nga kjo sëmundje; rreth 1600 veta vdesin si pasojë e kësaj sëmundjeje. Më shumë se 90 përqind të të sëmurëve janë mbi moshën 50 vjeç, ku meshkujt preken pak më shpesh sesa femrat. Megjithatë, edhe të rinjtë mbartin një rrezik të lartë nëse njëri nga prindërit ose vëllezërit apo motrat e tyre janë diagnostikuar me kancer të zorrës ose polipe të zorrës. Sa më i lartë të jetë numri i të afërmeve të sëmurë, aq më i lartë është rreziku. Njësoj ndodh edhe në rastin e ndryshimeve të trashëgueshme dhe gjenetike.

Shumica e sëmundjeve të kancerit në zorrë diagnostikohen në një fazë të vonshme, pasi shpesh sqarimet ndodhin me shfaqjen e simptomave dhe, në të shumtën e rasteve, sëmundja ka përparuar. Nëse kanceri i zorrës zbulohet në një fazë të hershme, në të shumtën e rasteve është i shërueshëm. Sot, norma 5 vjeçare e mbijetesës është rreth 60 përqind.



## Simptomat

Sipas hipotezave, polipeve beninje u duhen rreth dhjetë vite derisa të zhvillohen në kancer. Polipet dhe tumoret në një fazë të hershme, në të shumtën e rasteve nuk shkaktojnë shqetësime.

Prania e gjakut në fekale është një nga simptomat më të rëndësishme dhe më të hershme të kancerit në zorrë. Megjithatë, gjaku mund të jetë edhe i padukshëm (i fshehtë) ose mund të mos vërehet. Të tjera simptoma të mundshme janë humbja në peshë, impuls për defekim, dhimbje barku të reja dhe të vazhdueshme ose parregullsi në defekim.

## Identifikimi i hershëm i kancerit në zorrë – ekzaminimi i identifikimit të hershëm

Ekzaminimet e identifikimit të hershëm kanë si qëllim të dallojnë një sëmundje që mund të ekzistojë para shfaqjes së simptomave. Nëse ekzaminimi i identifikimit të hershëm jep një rezultat të dukshëm, kryhen sqarime të mëtejshme për verifikimin ose përjashtimin e një sëmundjeje. Falë ekzaminimeve të identifikimit të hershëm, kanceri i zorrës shpesh mund të gjendet në një fazë të hershme, të shërueshme.

## Metodat për identifikimin e hershëm

Metodat që përdoren më shpesh për identifikimin e hershëm të kancerit të zorrës dhe fazave paraprake të tij janë prova për gjak të fshehtë në fekale dhe koloskopi. Një proces tjetër që jep tablonë e sëmundjes është kolonografia CT. Ndër zhvillimet më të fundit janë prova e ADN-së së fekaleve ose analizat e gjakut (përcaktimi i shenjave të tumorit).

## Koloskopia

Metoda më e besueshme për zbulimin e kancerit të zorrës dhe të zorrës dhe fazave paraprake është koloskopia. Përveç kësaj, koloskopia ofron avantazhin që, si rregull, fazat paraprake të zbuluara (polipet) të hiqen menjëherë gjatë ekzaminimit (polipektomi). Në fund, polipet ekzaminohen me mikroskop. Nëpërmjet heqjes së polipeve beninje mund të parandalohet shfaqja e mëvonshme e kancerit në zorrë.

Nëse nuk zbulohen polipe, atëherë rekomandohet një koloskopi tjetër pas dhjetë vjetësh, përndryshe, një ekzaminim ndjekës tregohet më herët.

Për më shumë informacione, shih [www.krebsliga.ch/darmkrebs](http://www.krebsliga.ch/darmkrebs).

Burimi: «Faktenblatt Früherkennung von Darmkrebs», Liga kundër kancerit e Zvicrës (Krebsliga Schweiz), Bern, © Shkurt 2014, KLS / 2.2014 / 8000 D / 1662





## Zbrazja e zorrëve (Evakuimi i zorrës)

- **A mund të punoj gjatë zbrazjes?**  
Nuk rekomandohet që të punoni, pasi gjatë përgatitjes njeriut i duhet të shkojë shpesh në tualet.
- **Nga cili moment bën efekt ilaçi i evakuimit?**  
Si rregull, brenda 1 – 3 orëve.
- **A është e rëndësishme që të pihet i gjithë ilaçi i evakuimit, apo mund të ndaloj nëse fekalet përmbajnë vetëm lëng të kthjellët?**  
Po. Për vlerësimin e saktë të membranës mukoze duhet që të pini të gjithë ilaçin.
- **Çfarë mund të bëj nëse, gjatë përgatitjes, bëhem keq?**  
Merrni një Motilium lingual (mund të merret pa recetë) dhe prisni 20 minuta para se të pini pjesën tjetër të ilaçit të evakuimit.
- **Më duhet të vjell, a është gjë e keqe kjo?**  
Jo. Kjo mund të ndodhë. Përpiquni të pini shumë lëngje, ideale do të ishte çaj i ngrohtë. Nëse villni kryesisht lëng të kthjellët, efekti i ilaçit të evakuimit ruhet.
- **Si mund të vij në klinikë pa më ndodhur një e papritur gjatë rrugës?**  
Një orë para se të largoheni nga shtëpia mos pini lëngje; atëherë, si rregull, udhëtimi bëhet pa problem.
- **A duhet të marr me vete ndërresa?**  
Si rregull nuk është e nevojshme. Në raste të veçanta merrni me vete ndërresa intime.
- **Ilaçin e evakuimit mezi e pi, çfarë mund të bëj?**  
Këshilla: Ftoheni Moviprep®, pijeni me kallam, futeni në një shishe plastike dhe pijeni nga shishja (ka më pak erë), pijeni duke mbajtur hundën mbyllur, hollojeni me lëng molle ose shurup, nëse është e nevojshme, përziejeni me lëng mishi, treni në të glukozë, pijeni me gllënjka të vogla (ka një shije të çuditshme).

- **Unë kam menstruacionet; a mund ta bëj koloskopinë?**  
Po. Nuk ka asgjë të veçantë që duhet marrë parasysh.

## Ekzaminimi

- **A do të marr narkozë?**  
Jo. Falë ilaçit të gjumit (propofolit), gjatë ekzaminimit nuk ndjeni asgjë, por zgjoheni menjëherë pas përfundimit të tij. Frymëmarrja dhe qarkullimi kardiovaskular nuk ndikohen.
- **A është me dhimbje ekzaminimi?**  
Jo, pasi, për kohëzgjatjen e ekzaminimit, do të merrni ilaç gjumi (propofol). Madje, shumë pacientëve, ekzaminimi u duket i rehatshëm.
- **A mund ta bëj ekzaminimin edhe pa ilaç gjumi?**  
Si rregull, kjo është e mundshme. Por, meqë koloskopia pa ilaç gjumi mund të jetë e pakëndshme, ju këshillojmë të mos e bëni pa ilaç gjumi.
- **A mund të shikoj gjatë ekzaminimit?**  
Po. Pavarësisht ilaçit të gjumit, shumicën e herëve mund të shikohet në pjesën e dytë.
- **Kam frikë nga ky ekzaminim; a është i rrezikshëm?**  
Jo. Koloskopia është një ekzaminim rutinë dhe si marrja e indeve, ashtu dhe heqja e polipeve janë me rrezik të ulët.
- **A mund të bëhen së bashku endoskopia e stomakut dhe koloskopia?**  
Po, ato mund të kombinohen gjatë një seance të vetme.
- **A mund të hiqen polipet gjatë ekzaminimit?**  
Po. Si rregull, ato mund të hiqen menjëherë me një pincë ose teleskop.

## Pas ekzaminimit

- **Pas ekzaminimit, a mund të ha menjëherë gjithçka?**  
Po. Pas ekzaminimit ju mund të hani gjithçka.
- **Pas ekzaminimit, a kam gurgullim zorrësh?**  
Për ekzaminimin përdorim CO<sub>2</sub>, i cili thithet shumë shpejt nga trupi. Prandaj nuk ka pothuajse aspak gurgullimë zorrësh.
- **A dëmtohet flora e zorrëve?**  
Jo. Në rast individual mund të merren probiotikë (bioflorin).

- **A ndalon diarrea menjëherë pas ekzaminimit?**  
Po. Si rregull, ajo ndalon pas marrjes së fundit të tretësirës së evakuimit.
- **Pas ekzaminimit, a mund të shkoj vetëm në shtëpi?**  
Po. Të moshuarve ju rekomandojmë që të shoqërohen nga një person tjetër.
- **A informohem menjëherë pas koloskopisë në lidhje me rezultatin e ekzaminimit?**  
Po. Gjetjet e dukshme (polip po/jo) tregohen menjëherë. Në rastin e kampionëve të indeve ju merrni një raport të detajuar brenda dy deri tri ditëve.

### Sëmundjet dhe medikamentet

- **Unë jam diabetik; çfarë duhet të kem parasysh?**  
Mos merrni X-Prep®. Në rastin e diabetit ku duhet marrë insulinë, tregoni kujdes që të arrihet një vlerë „e lartë“ sheqeri (deri 8 mmol/l). Nëse është e mundur, lini një takim për pasdite. Nëse keni pyetje të tjera, lutemi të na kontaktoni.
- **Si duhet të marrë medikamentin/insulinën e diabetit para koloskopisë?**  
Si rregull, në ditën e ekzaminimit nuk duhet të merren medikamente për diabetin. Nëse përdoret një insulinë bazike, ju rekomandojmë që, një ditë përpara (në mbrëmje), ta reduktoni dozën e insulinës në 30 përqind. Meqë në ditën e ekzaminimit jeni esëll, para koloskopisë nuk duhet të injektohet bolusinsulinë. Nëse vuani nga një melitozë e diabetit që kërkon insulinë, atëherë do t'ju luteshim që, menjëherë para ekzaminimit, ta matnit edhe një herë sheqerin në gjak.
- **A mund të marr medikamentet e mia gjatë evakuimit?**  
Jo. Ato duhet t'i merrni vetëm pas koloskopisë, pasi është e mundur që të shpëlahen dhe të mos bëjnë efektin e zakonshëm.
- **A duhet të bëhet hollimi i gjakut?**  
Në terapi individuale, mund të merren plavix dhe aspirinë cardio. Për të gjitha medikamentet e tjera të hollimit të gjakut (Marcoumar, Xarelto) duhet të bisedoni me mjekun e familjes ose me ne.

### Çështje organizimi

- **Sa kohë duhet të planifikoj te ju?**  
Për koloskopinë rreth 1,5 orë, për endoskopinë e stomakut rreth 1 orë, përfshirë bisedën përmbyllëse.
- **A mund të punoj pas koloskopisë?**  
Një gjë e tillë nuk rekomandohet. Pacientëve që kanë profesione, të cilat kërkojnë drejtimin e automjeteve ose operimin e makinerive të rënda, nuk u lejohet të punojnë në ditën e ekzaminimit.
- **A mund ta drejtoj makinën pas koloskopisë?**  
Jo. Drejtimi i automjeteve gjatë 12 orëve pas ekzaminimit nuk lejohet për shkak të medikamenteve të marra.
- **A më jepet një dëshmi për paaftësi pune (AUFZ)?**  
Po. Për ditën e ekzaminimit, ne lëshojmë një AUFZ.
- **Pas ekzaminimit, a mund të ushtroj menjëherë sport?**  
Po. Duhet evituar sporte të caktuara, si p.sh. noti, kacavjerrja dhe drejtimi i biçikletës.
- **A jam përsëri në gjendje të nesërmen dhe a mund të bëj gjithçka?**  
Po. Të nesërmen nuk ka më kufizime.

### Të ndryshme

- **A mbulohet koloskopia nga sigurimi shëndetësor?**  
Nëse ekzistojnë shqetësime të zorrës ose si ekzaminim parandalues (midis moshës 50 dhe 69 vjeç) bëhet mbulimi i kostove (pa përjashtim të taksave).
- **Pse duhet ta paguaj vetë X-Prep®?**  
X-Prep® nuk mbulohet nga sigurimi shëndetësor, as nga sigurimi shtesë, pasi ai gjendet në listën e preparateve farmaceutike me përdorim të posaçëm (LPPV).



## Rreth nesh

Që nga viti 1969, Central-Praxis në rrugën „Weinbergstrasse 26“ drejtohet nga specialistë të stomakut dhe zorrëve. Fillimi u ndërmor nga Dr. med. Felix Fierz – asokohe President i Mjekëve të Kantonit të Zyrhut – pasi e mori klinikën nga Dr. med. Werder Biber. Në vitin 1981, atë e ndërroi gastroenterologu Dr. med. Andreas Dolder, i cili praktikon këtu mbi 31 vjet. Që nga viti 2012, i biri, Dr. med. Mathias Dolder – edhe ai specialist i stomakut dhe zorrëve – vazhdon më tej traditën. Që nga viti 2015, Dr. med. Mathias Dolder dhe Dr. med. Martin Wilhelmi e drejtojnë klinikën së bashku.



### Dr. med. Mathias Dolder

Mjek specialist FMH për gastroenterologji dhe hepatologji  
Mjek i përgjithshëm FMH për mjekësi të brendshme të përgjithshme  
Certifikatë e aftësisë FMH mjek urgjence SGNOR



### Dr. med. Martin Wilhelmi

Mjek specialist FMH për gastroenterologji dhe hepatologji  
Mjek i përgjithshëm FMH për mjekësi të brendshme të përgjithshme  
Certifikatë e aftësisë FMH sonografi SGUM